



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DEVOLL
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Bilisht, më _____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Materiale per Lyerjen e Shkollave"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Bojra
44810000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,561,910 (nje milion e peseqind e gjashtëdhjete e nje mijë e nëntëqind e dhjete) leke pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar , nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Devoll** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 ;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar .

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin76"Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbështetje te Nenit 26"Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit e shtojces (Shtojca 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros mesatare vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2021, 2022 dhe 2023) lëshuar nga Administrata Tatimore, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vietet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës të përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti koontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontratës ,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të shërbimit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit të mallrave me mjetet dhe shpenzimet e tij pranë Autoritetit Kontraktor**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër të kryejnë shërbimin e transportit në adresën e përcaktuar të Autoritetit Kontraktor. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 11 të LPP-së dhe në to përcaktohen qartë karakteristika e mallit objekt prokurimi duke mos përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Specifikimet teknike në rastin konkret nuk përbëjnë pengesë për konkurrencën e hapur dhe pjesënarrjen e OE të cilët tregëtojnë bojra dhe materiale të tjera.

Specifikimi i Materialeve:

1.Specifikimet teknike për bojën akrelik

- a.Paketimi: 10 litra
- b. Aftesi të mira ngjitje, mbulim shumë të mirë
- c. duhet të jetë rezistente ndaj ujit dhe kushteve të pafavorshme të motit.

- d. të mos ketë ndryshime të cipës së bojës (as fryrje, petezim, plasaritje apo pluhërim të shtresës së bojës)
- dh. E përshtatshme për suva, beton, tullë.
- f.hollimi me 5-10% ujë
- g. Ngjyra: e Bardhe.

2.Specifikimet teknike për bojën plastiko

- a.Paketimi: 10 litra
- b. Aftesi të mira ngjitje, mbulim shumë të mirë

- c. Ekologjike, per ambjente te brendshme
- d. te mos ketë ndryshime te cipes se bojës (as fryrje, petezim, plasaritje apo pluhurizim te shtresës se bojës
- dh. E pershtatshme per suva, beton, tulle.
- f. hollimi me 5-10% uje
- g. Ngjyra: e Bardhe.

3.Specifikimet teknike per Astar me baze nefti

- a. Paketimi: 15 litra
- b. Aftesi te mira ngjitje

4.Specifikimet teknike per Neft

- a. I zakonshem
- b. Paketimi: 15 litra

5.Specifikimet teknike per Bojen Hidromat

- a. Paketimi 10 litra
- b. Ngjyra: E bardhe
- c. Niveli i Shkelqimit: Mat
- d. Te perdoret per te gjitha muret (brendshme- jashtme) mbi Suva, mure, Allci, cemento, gipsi etj.
- e. Bardhesia > 90 (ASTM E 313-98)
- f. Indeksi i verdhësisë ~0 (ASTM E 313-98)
- g. Perdorimi me: Furce, Rul, Sperkates
- h. Te hapet mire
- i. Te mos pikoje
- j. Koha e rilyerjes: 2-3 ore
- k. Tharja e plote: 4 ore

6.Specifikimet teknike per Pigment

- a. Per perdorim me kompjuter
- b. Ngjyrat do te percaktohen gjate zbatimit te kontrates

7.Specifikimet teknike per gelqeren

- a. Per perdorim me furce
- b. E njetrajtshme dhe jo e holle

8.Specifikimet teknike per Rula

- a. Me material nga leshti I deles dhe te dendur
- b. Cilesor dhe jetegjate
- c. Gjatesi 25 Cm

9.Specifikimet teknike per Rula te zakonshem

- a. Rula te zakonshem

10.Specifikimet teknike per Furca Gelqere

- a. Me fije te gjate dhe te dendur
- b. Gjatesi 25 Cm

11.Specifikimet teknike per Furca boje vaji

- a. Me fije te gjate dhe te dendur

12.Specifikimet teknike per Skafe

- a. Skafe e madhe
- b. Cilesore

13.Specifikimet teknike per Furca per prerje tavani

- a. Me fije te gjate dhe te dendur
- b. E thyeshme deri 90°

14.Specifikimet per boje vaji

- a. Te aplikohet me rul, furce dhe pistolette
- b. te jete kunder lageshtires
- c. te aplikohet per mure, dru, metal
- d. shkelqimi 60 njesi ne 60

15.Specifikimet per tretes boje vaji

- a. Dylent nitro

16.Specifikimet per tenie leter

- a. Ngjites leter per lyerje 5cm * 50m

17.Specifikimet per Steka per rula

- a. Me gjatesi te pakten 2 m
- b. cilesore

18.Specifikimet per Mistri

- a. Standarte e madhe
- b. cilesore

19.Specifikimet per Skriste e madhe

- a. Me gjerësi te pakten 22 cm
- b. cilesore

20.Specifikimet teknike per stuko patinimi

- a. Paketimi: 25 kg
- b. Perberja Cimento e bardhe, gelqere e hidratuar, pluhur mermeri I bardhe

c. te kete punueshmeri dhe hapje te lehte, per ambjente te jashtme dhe te brendshme
d. lejon nje trashesi nga 0 deri 3mm per cdo dore dh. Stukimi I faqeve prej betoni, I mureve dhe tavaneve prej kartongipsi

e.Lloji I artikullit” Pluhur
f. Ngjyra: bardhe
g. Raporti I perzjerjes 4.5-5 litra uje per 15 kg
gj.Akrelike

Njesia e Prokurimit: